



NJOFTIM

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe të Rregullores (QRK) - Nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka caktuar zyrtarin për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit z. **Faton Morina**, Zyrtar i lartë i rishqyrtimit në Divizionin e rishqyrtimit.

Po ashtu në pajtim me nenin 7 (paragrafi 1.2) të Rregullores së cekur më lart është hapur një adresë e veçantë ku zyrtarët e BQK-së mund t'i paraqesin, përkatësisht raportojnë pretendimet e tyre për shkelje ligjore.

Adresa është: bqk.sinjalizimi@bqk-kos.org

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës inkurajon stafin që të adresojnë shkeljet eventuale brenda Bankës Qendrore me qëllim të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm.